



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:255436

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453146

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0747-A0001

*Paditës*

**Sh K** me përfaqësues sipas autorizimit avokatin B I, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

**N.SH. “Famipa”** (në likuidim), Prizren, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1705, të datës 13 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

- Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
- Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1705, i datës 13 nëntor 2023.
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësi së bashku me një grup punëtorësh kishte parashtruar një padi grupore, mirëpo me urdhrin e gjykatës me nr. C-IV-13-2002 i datës 26 gusht 2014 ishte bërë ndarja e padive.

Me vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013, kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në shumën prej 1,560.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme pasi që ishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së në kohën e privatizimit të N.SH-së dhe nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia.

Me datë 10 shtator 2015, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë për rregullimin dhe plotësimin e padisë. Në këtë parashtrësë kishte theksuar se paditësi ka vetëm një të vërtetë të cilën AKP e kishte konstatuar me tekst të shkruar me dokumentin e saj zyrtar të titulluar “Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës” të vulosur nga AKP-ja dhe nënshkruar nga Drejtori i Departamentit të Likuidimit. Praktika gjyqësore e DHPGJS-së në rastin e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në N.SH “Famipa”, është e qartë. Bindëse dhe konsistente. Aktgjykimet e kësaj gjykate kanë anuluar vendimet e AL-së dhe kanë miratuar kërkesat e punëtorëve për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës. Gjithashtu, Kolegji i Apelit në rastin e S B AC-I-14-0323 të datës 12 mars 2005, kishte vërtetuar se letërpezullimi i lëshuar nga AKM/AKP është njohje e detyrimeve ndaj kreditorëve. Andaj paditësi gjykatës i kishte propozuar që të miratohet në tërësi padia e tij si e bazuar, ashtu që të obligohet AKP që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës t’i paguaj paditësit shumën e borxhit prej 1,800.00 euro, interesin ligjor prej 10% dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit.

Me datë 27 mars 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin, përmes të cilit kishte kërkuar nga i njëjti që të dorëzoj në gjykatë provat në mbështetje të ankesës së tij.

Me datë 12 prill 2023, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e lartcekur të gjykatës duke dorëzuar në DHPGJS këto prova: kopjen e librezës së punës së paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 16 shtator 2011, formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013, ankesën e datës 25 shtator 2013 të paraqitur nga punëtorët e N.SH “Famipa” si dhe listën e punëtorëve që kanë dorëzuar padi për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës.

Me datë 18 prill 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën kishte theksuar se listat e pagave për 6 muajt e fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit e paraqitur nga menaxhmenti i N.SH-së nuk pasqyrojnë ndonjë pagesë të kryer ndaj

parashtruesit të kërkesës. Ky Autoritet i Likuidimit vë nën se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH kur u privatizua N.SH-ja. Parashtruesi i kërkesës nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia. Andaj e paditura duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 13 nëntor 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1705 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke ndryshuar kështu vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013, ashtu që kishte obliguar të paditurën që paditësit në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t'ia paguaj për 7 paga shumën prej 1,560.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shumën prej 156.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi gjykata kishte vlerësuar se me provën e njoftimit të lëshuar nga AKP me datë 16 shtator 2011 për paditësin, ky i fundit është njoftuar se punësimi i tij i përfundon si pasojë e shitjes së aseteve. Me provën e formularit të kërkesës kreditore të datës 10 korrik 2013, paditësi kishte ushtruar kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme për 7 paga mujore për pagë mujore në lartësi prej 220.00 euro x 7 paga, gjithsej shumën prej 1,560.00 euro. Gjykata kishte vlerësuar se paditësi me provën e njoftimit kishte vërtetuar faktin se deri tek ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur me veprimin e AKP-së. Përderisa AKP me asnjë provë sipas parimit të barrës së provës nuk ka vërtetua pretendimin e saj se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv në ditën e privatizimit të ndërmarrjes. Gjithashtu nga kopja e librezës së punës së paditësit është vërtetuar se paditësi kishte punuar në ndërmarrje nga 24 qershor 1970 deri me 16 shtator 2011 dhe se ka përvujtë pune mbi 37 vite. Gjykata përkundër faktit se paditësi nuk ka ofruar dëshmi mbi lartësinë e pagës mujore gjatë vitit 2011, duke u mbështetur në formularin e kërkesës kreditore kishte vlerësuar se nuk është kontestuese se lartësia e pagës mujore ka qenë 220.00 euro.

Me datë 8 dhjetor 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-15-1705 të datës 13 nëntor 2023 (aktgjykim i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e

ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me "Afatin për parashtrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëj me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013.

Me datë 2 shtator 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet..

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,560.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se nga dokumentacioni i nxjerrë nga arkiva e ndërmarrjes vërtetohet fakti se parashtruesi i kërkesës nuk figuron si një punëtor i N.SH-së në kohën e privatizimit të N.SH-së.

Paditësi në shkallë të parë me rastin e paraqitjes së ankesës së tij kishte bashkëngjitur këto prova: kopjen e librezës së punës së paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 16 shtator 2011, formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, vendimin e

ankimuar të AL-së me nr. PRZ024-0297 të datës 12 shtator 2013, ankesën e datës 25 shtator 2013 të paraqitur nga punëtorët e N.SH “Famipa” si dhe listën e punëtorëve që kanë dorëzuar padi për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës..

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte aprovuar ankesën e paditësit dhe i kishte njohur të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,560.00 euro, interesin ligjor prej 10% si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro, me arsyetim se ankuesi kishte dorëzuar prova relevante që vërtetojnë pretendimet e tij përderisa e paditura me asnjë provë nuk e ka dëshmuar të kundërtën e asaj që e kishte provuar paditësi.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet që i njëjti ka ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me datë 16 shtator 2011, ditë kjo kur edhe i ishte mbyllur librezja e punës.

Provë relevante në këtë rast ishte edhe Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me datë 16 shtator 2011. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë me datë 16 shtator 2011, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

E paditura në rastin konkret asnjëherë nuk e kishte kontestuar lartësinë e kërkesës për kompensim nga ana e paditësit. Andaj faktet e pakontestuar konsiderohen si të vërtetuara.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë e DHPGJS kishte vendosur drejtë kur paditësit i kishte njohur të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,560.00 euro.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_